



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 128/3 prot.

Tiranë, më 27. 2 2019

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për vitin 2018

MINISTRISË SË FINANCAVE  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT  
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE POLITIKAVE BUXHETORE  
(Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë)

Me ligjin 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", janë miratuar fondet buxhetore për Institucionin e Komisionerëve Publikë. Bazuar në këtë ligj dhe sipas përcaktimeve në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenin 19, institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve zbatojnë në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre të miratuar nga Kuvendi.

Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit, por edhe në respekt të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në ligjin nr.109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.3.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2018.

Situata buxhetore për vitin 2018 paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi Fakti 12-mujor/progresiv	Realizimi në %
Shpenzime Korente	58,200	44,355	42,027	94.8%
Shpenzime Kapitale	9,000	5,800	4,396	75.8%
<b>TOTALI</b>	<b>67,200</b>	<b>50,155</b>	<b>46,423</b>	<b>92.6%</b>

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit, në vlerë 67,200 mijë lekë, në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale, janë rishikuar me akte normative dhe konkretisht janë pakësuar me aktin

normativ nr.1, datë 26.7.2018, në zërin shpenzime personeli dhe me aktin normativ nr. 2, datë 19.12.2018, në shpenzime korente dhe kapitale, duke arritur në vlerën 50,155 mijë lekë.

Lidhur me performancën e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2018, në nivelin 92.6%, është e nevojshme të analizojmë ecurinë e përdorimit të këtyre fondeve gjatë vitit dhe shkaqet objektive që kanë ndikuar në shkallën e realizimit të treguesve buxhetorë.

- Siç ju kemi bërë me dije dhe në raportimet e mëparshme, në fillimet e tij, institucioni ka ushtruar aktivitetin pranë zyrave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me struktura organike të paplotësuara. Gjatë kësaj periudhe jemi asistuar nga KPK-ja me furnizimin e të gjithë bazës materiale të nevojshme. Gjithashtu, nuk janë kryer pagesa për energji elektrike, ujë, shërbime postare dhe shërbime të tjera, të zakonshme në veprimtarinë e një institucioni. Në këto kushte, gjatë kësaj periudhe, nuk është kryer asnjë shpenzim në këtë drejtim nga fondet buxhetore të miratuara në shpenzime operative.

Në fillim të muajit qershor, Institucioni i Komisionerëve Publikë është akomoduar në ish-godinën e Kontrollit të Lartë të Shtetit të rikonstruktuar dhe të mobiluar nga Ministria e Drejtësisë. Me plotësimin e stafit të nevojshëm administrativ, nëpërmjet procedurave ligjore të rekrutimit, u rritën shpenzimet e personelit në paga dhe sigurime shoqërore, nisën procedurat e parashikuara të prokurimeve në mallra e shërbime, duke plotësuar nevojat emergjente dhe nevojat e shtuara të institucionit në letër, kancelari, shtypshkrime, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrave, materiale pastrimi etj. Në vijim, me lidhjen e kontratave për shërbimet postare, telefonike, energji dhe ujë, u rritën shpenzimet mujore të tyre për periudhën e mbetur të vitit.


Çdo shpenzim për furnizimin materialo-teknik të stafit të institucionit dhe administrimin e institucionit është kryer konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2018 dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Janë finalizuar me sukses pothuajse të gjithë procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime të parashikuara në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2018.

Në mënyrë analitike, në formë tabelare dhe grafike, performanca e objektivave dhe e realizimit të shpenzimeve për vitin 2018, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim.

#### Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor Plani i rishikuar	Realizimi Fakti 12-mujor/progresiv	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	54,200	38,855	37,590	96.7 %

602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	4,000	5,500	4,437	80.7 %
231	Shpenzime kapitale	9,000	5,800	4,396	75.8 %
	<b>TOTALI</b>	<b>67,200</b>	<b>50,155</b>	<b>46,423</b>	<b>92.6 %</b>



- Grafiku i realizimit të buxhetit 2018 sipas artikujve (në mijë lekë)

1. **Artikulli 600 dhe 601**, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2018 për këtë zë është 54,200 mijë lekë dhe buxheti pas rishikimit me aktet normative dhe akordimit të fondit për shpërbimin e fundvitit arriti në 38,855 mijë lekë. Për 12-mujorin, realizimi faktik i shpenzimeve të personelit është 37,590 mijë lekë ose 96.7% e fondit të rishikuar. Ky nivel i realizimit është arritur për shkak të mosplotësisë së strukturave organike deri në muajin qershor, gjë që ka sjellë krijimin e fondeve të lira të mbartura në muajt në vazhdim. Theksojmë se niveli i pagave të strukturave të institucionit është përcaktuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, të ndryshuar me vendimin nr.102/2018. Numri i punonjësve në fund të vitit 2018 është 29 veta. Në 1 janar 2019, struktura e miratuar prej Kuvendit, prej 30 vetësh, u plotësua dhe tashmë institucioni funksionon me strukturë të plotë.

Me fondin e miratuar në paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2018 është realizuar pagesa e të gjithë stafit sipas përcaktimeve në vendimet e sipërcituara të Kuvendit të Shqipërisë, pagesa për të gjitha elementet e pagës, përfshirë dhe shtesën për vështirësi për Njësinë Ligjore, përcaktuar nga Mbledhja e Komisionerëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe

është kryer pagesa e shpërblimit të fundvitit për Komisionerët Publikë, Njësinë Ligjore dhe Njësinë Administrative, sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 31.12.2018.

2. **Artikulli 602**, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2018 është 4,000 mijë lekë dhe pas rialokimit të fondeve me kërkesën e institucionit, nëpërmjet transferimit nga fondi i pagave, ky buxhet arriti në vlerën 6,500 mijë lekë. Pas rishikimit të buxhetit me aktet normative të Këshillit të Ministrave, buxheti në fund të vitit 2018 në këtë zë arriti në vlerën 5,500 lekë. Për 12-mujorin, shpenzimet faktike për mallra dhe shërbime janë 4,437 mijë lekë ose 80.7% e buxhetit vjetor të rishikuar.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	3,478	3,335
2	Shërbime	1,154	815
3	Shpenzime transporti	264	233
4	Shpenzime mirëmbajtjeje të zakonshme	230	6
5	Shpenzime të tjera speciale	374	48
	<b>TOTALI</b>	<b>5,500</b>	<b>4,437</b>


Ky nivel i realizimit të fondeve është arritur në 6-mujorin e dytë të vitit, pas plotësimit të strukturës organike dhe akomodimit në ambientet e reja të punës, pasi në fillim të vitit nevojat tona, siç shpjegohet më lart, janë plotësuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Meqenëse procedurat e prokurimit zgjasin në kohë për shkaqe të ndryshme dhe realizimi i fondit limit të përcaktuar për blerjet varet nga ofertat ekonomike të paraqitura dhe nga numri i ofertuesve, rezulton që një pjesë e këtyre shpenzimeve janë më të vogla se fondi i parashikuar. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar procedurat e prokurimit për materiale dhe shërbime, kryesisht materiale zyre, si: tonera, që zë dhe pjesën më të madhe të fondeve të prokuruar, letër, karburant për automjetet dhe gjenerator, si dhe blerje me procedura të thjeshtuara për kancelari, materiale pastrimi, materiale të ndryshme zyre, ujë të pijshëm për punonjësit, siguracion makine, sinjalistika etj. Po kështu, shpenzimet e transportit nuk janë në nivelin e parashikimit për shkak të shtyrjes deri në dhjetor të procedurës së blerjes së automjetit. Shpenzimet për drita, ujë, telefon, postë etj., janë të lidhura me akomodimin në ambientet e reja të punës dhe me kohën e lidhjes së kontratave të këtyre shërbimeve.

3. **Artikulli 231**, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull për vitin 2018 është 9,000 mijë lekë dhe, me rishikimin e buxhetit me aktet normative, ky buxhet në fund të vitit arriti në vlerën 5,800 mijë lekë. Realizimi faktik i shpenzimeve në investime për vitin 2018 është 4,396 mijë lekë ose 75.8% e buxhetit të miratuar në këtë zë. Niveli i realizimit të fondeve në këtë artikull është në përputhje me nevojat reale të institucionit pas akomodimit në ambientet e reja. Vlen të theksohet fakti që parashikimi i këtij fondi është kryer gjatë vitit 2017, kohë në

të cilën ka qenë e paqartë situata e hapësirave që do të kishte në dispozicion institucioni dhe, për pasojë, e nevojave për pajisje e mobilie për akomodimin e stafit.

Në mënyrë analitike, realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2018, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim në formë tabelare dhe grafike, me shpjegimet përkatëse për çdo projekt investimi.

Investimet	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi Fakti 12 - mujor/progresiv	Realizimi në%
Blerje pajisje elektronike	960	960	832	86.7%
Blerje pajisje dhe mobilie zyre	3,040	2326	1,049	45.1%
Software i menaxhimit të çështjeve	2,200	0	-	-
Software i aktivitetit financiar	300	120	120	100%
Blerje automjeti	2,500	2394	2,394	100%
<b>TOTALI</b>	<b>9,000</b>	<b>5,800</b>	<b>4,395</b>	<b>75.8%</b>



Bazuar në VKM-në nr. 518, datë 20.9.2017, të ndryshuar, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Komisionerët Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016”, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për sistemimin në mjediset e punës dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve. Nga kjo Ministri është kryer në pjesën më të madhe mobilimi i ambienteve, si dhe furnizimi me pajisje elektronike.

Pas akomodimit në ambientet e reja të punës, në 6-mujorin e dytë të vitit 2018, u realizuan procedurat e prokurimit për pajisje kompjuterike, pajisje - mobilie, si dhe blerjen e programit financiar Financa 5, duke plotësuar kështu nevojat shtesë të stafit, me qëllim krijimin e ambienteve të përshtatshme dhe sigurimin e pajisjeve për stafin e ri të institucionit, për 4 Këshilltarë të Njësisë Ligjore.

Gjithashtu, në muajin dhjetor 2018, u finalizua dhe procedura e blerjes së automjetit për nevoja të institucionit, procedurë e cila u zhvillua nga Autoriteti ynë Kontraktor, pas anulimit të procedurës së nisur nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, pranë Ministrisë së Brendshme.

Për sa i përket fondeve të planifikuara në fillim të vitit 2018, për blerjen e programit të menaxhimit të çështjeve, theksojmë se, për shkak se Institucioni i Komisionerëve Publikë është në negociata me organizma ndërkombëtarë, që do të mbështesin këtë projekt për të tria institucionet e rivlerësimit dhe pamundësisë që ky projekt të realizohej këtë vit, në fund të vitit 2018 u pakësuan fondet e planifikuara, duke arritur në vlerën 0.

Si përfundim, mund të themi që Institucioni i Komisionerëve Publikë, si një institucion i ri, gjatë vitit të parë të veprimtarisë së tij, në vlerësimin tonë ka arritur një performancë të mirë të realizimit të fondeve buxhetore, duke përballuar sfidat dhe vështirësitë e fillimit.

Bashkëlidhur gjeni tabelat shoqëruese të raportit të monitorimit për vitin 2018.

Duke ju falënderuar,

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Florian Ballhysa

Darjel Sina




Konceptoi: A. Kastrioti  
Miratoi: A. Çeli

**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

ne 000/leke



Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	(2) PBA Viti 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	4,787	79,200	67,200.0	50,155.0	50,155.0	46,423.0	-3,732.0	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		4,787.00	79,200	67,200.0	50,155.0	50,155.0	46,423.0	-3,732.0	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		4,787.00	79,200.0	67,200.0	50,155.0	50,155.0	46,423.0	-3,732.0	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Celi
	Firma			Firma	
	Data	27.2.2019		Data	27.2.2019

**ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2017	(2) PBA Plan 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar viti korrent 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhës 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhës/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	4,522.0	49,400.0	49,400.0	35,555.0	35,555.0	34,640.0	-915.0
601	Sigurime Shoqërore	265.0	4,800.0	4,800.0	3,300.0	3,300.0	2,950.0	-350.0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		5,000.0	4,000.0	5,500.0	5,500.0	4,437.0	-1,063.0
603	Subvencione							0.0
604	Transferta Korente të Brendshme							0.0
605	Transferta Korente të Huaja					0.0	0.0	0.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ					0.0	0.0	0.0
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>4,787.0</b>	<b>59,200.0</b>	<b>58,200.0</b>	<b>44,355.0</b>	<b>44,355.0</b>	<b>42,027.0</b>	<b>-2,328.0</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara				120.0	120.0	120.0	0.0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	20,000.0	9,000.0	5,680.0	5,680.0	4,276.0	-1,404.0
232	Transferta Kapitale							0.0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>0.0</b>	<b>20,000.0</b>	<b>9,000.0</b>	<b>5,800.0</b>	<b>5,800.0</b>	<b>4,396.0</b>	<b>-1,404.0</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara							0.0
231	Kapitale të Trupëzuara							0.0
232	Transferta Kapitale							0.0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>0.0</b>	<b>20,000.0</b>	<b>9,000.0</b>	<b>5,800.0</b>	<b>5,800.0</b>	<b>4,396.0</b>	<b>-1,404.0</b>
<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>							<b>0.0</b>	
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>4,787.0</b>	<b>79,200.0</b>	<b>67,200.0</b>	<b>50,155.0</b>	<b>50,155.0</b>	<b>46,423.0</b>	<b>-3,732.0</b>

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Celi
	Firma			Firma	
	Data	27.2.2019		Data	27.2.2019



ANEKSI nr.3 "Raporti përmblidhës i realizimit të kërkesave të performancës/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik	3360



Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njësia matëse	I				II				III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi			Komente
			Sasia Faktike (sipas vitit 2017)	Shpenzimet (sipas vitit 2017)	Kosto për Njësi (sipas vitit 2017)	Sasia (sipas planit të vitit 2018)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2018)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2018)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit 2018)	Shpenzimet (sipas planit të rishikuar të vitit 2018)	Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar të vitit 2018)	Sasia Faktike për 12 muajt e vitit 2018	Shpenzimet Faktike për 12 muajt e vitit 2018	Kosto për Njësi për 12 muajt e vitit 2018	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III			
96304AA	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afateve ligjore	nr. Çështjesh të njoftuara	0	4,787	#DIV/0!	80	58,200	728	80	44,355	554	77	42,027	546	#DIV/0!	-25%	-2%	.....		
M630013	Blerje pajisje elektronike	sete pune	0	0	#DIV/0!	6	960	160	6	960	160	10	833	83	#DIV/0!	-48%	-48%	.....		
M630002	Blerje mobilje zyre	sete pune	0	0	#DIV/0!	30	3,040	101	30	2,326	78	12	1,049	87	#DIV/0!	-14%	13%	.....		
M630020	Blerje Automjeti	numër mjedesh	0	0	#DIV/0!	1	2,500	2,500	1	2,394	2,394	77	2,394	31	#DIV/0!	-99%	-99%	.....		
M630021	Blerje software menaxhimi i çështjeve	numër	0	0	#DIV/0!	1	2,200	2,200	1	0	0	77	0	0	#DIV/0!	-100%	#DIV/0!	.....		
M630022	Blerje software aktiviteti financiar	numër	0	0	#DIV/0!	1	300	300	1	120	120	77	120	2	#DIV/0!	-99%	-99%	.....		

Nepunësi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.2.2019		Data	27.2.2019

**ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"**

Periudha e Raportimit: 12 mujori 2018

Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:							Komente
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik							
<b>*Objektivat e politikës*:</b>		<b>Kodi i Treguesit te Performances/Produktit</b>	<b>Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit</b>	<b>Niveli faktik i vitit 2017</b>	<b>Niveli i planifikuar ne vitin 2018</b>	<b>Niveli i rishikuar per 12 mujorin e vitit 2018</b>	<b>Niveli faktik per 12 mujorin e vitit 2018</b>	<b>% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit</b>	
<b>Objektivi 1.1</b>	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."	96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	0	80	80	77	96%	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.2.2019		Data	27.2.2019

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"										
Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)										
Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Buxheti i	Plani i buxhetit viti 2018	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2018	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
		e projektit	të projektit	të projektit	Kontraktuar					
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	3,040	2018	2018	1,049	3,040	1,049	1,049	1,049	Jane plotesuar nevojat e shtuara per mobilje dhe pajisje meqenesis mobilimi I ambienteteve eshte kryer nga Ministria e Drejtesise. Plani I rishikuar pas akteve normative per kete projekt eshte 2,326
M630013	Pajisje elektronike	960	2018	2018	832	960	832	832	832	Jane plotesuar nevojat e shtuara per pajisje kompjuterike. Diferencat vijne si rezultat I vlerave te kontraktuara ne procedurat e prokurimit
M630021	Software menaxhimit çeshtjeve	2,200	2018	2018	-	2,200	-	-	-	Realizimi i ketij programi eshte ne proces diskutimi me OSBE dhe organet e tjera te vetingut. Plani I rishikuar pas akteve normative per kete projekt eshte 0
M630022	Software aktiviteti financiar	300	2018	2018	120	300	120	120	120	Realizuar plotesisht. Plani eshte rishikuar pas akteve normative dhe vlera e ketij projekti eshte 120.
M630020	Automjet per institucionin	2,500	2018	2018	2,394	2,500	2,394	2,394	2,394	Realizuar me sukses. Plani eshte rishikuar me akte normative dhe vlera e ketij projekti eshte 2,394.
<b>TOTALI</b>		<b>9,000</b>			<b>4,392</b>	<b>9,000</b>	<b>4,392</b>	<b>4,392</b>	<b>4,392</b>	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastri	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.2.2019		Data	27.2.2019